| **Buletini Nr. 241/ 2023, 07-11-2023** | **Parashikimi** nga 07-11-2023, ora 12:00 deri më 08-11-2023, ora 23:59. |
|---|---|

## PARASHIKIMI METEO

----------------------

### RESHJET

Sot pasdite (e martë, dt.07) priten reshje të dobëta lokale në qarqet veriore. Nesër (e mërkurë, dt.08) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarkun Shkodër. Në qarqet Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës dhe Tiranë priten reshje intensive, ndërsa në qarqet Elbasan, Fier dhe Berat priten reshje mesatare. Në qarqet e tjerë priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Reshjet do të shoqërohen me shtrëngata dhe shkarkesa elektrike në të gjithë qarqet.

Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve për momente të shkurtra mund të krijojë probleme të ndryshme si dhe vërshime të ujit në zonat urbane në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës dhe Tiranë.

### TEMPERATURAT

Nesër (e mërkurë, dt.08) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 17 / 22 °C

në vendet e ulëta: 14 / 19 °C

në vendet malore: 11 / 15 °C

### ERA

Sot pasdite (e martë, dt.07) dhe nesër (e mërkurë, dt.08), era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LARTË** |
|---|---|---|---|---|

| **Buletini Nr. 241/ 2023, 07-11-2023** | **Parashikimi** nga 07-11-2023, ora 12:00 deri më 08-11-2023, ora 23:59. |
|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret*** ***Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe*** ***Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe*** ***Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | S'KA RREZIK | intensive | shumë intensive | | | | |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| **DIBËR** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| **LEZHË** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| **DURRËS** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| **TIRANË** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| **ELBASAN** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **FIER** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **BERAT** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **KORÇË** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **VLORË** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **GJIROKASTËR** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |

| **Buletini Nr. 241/ 2023, 07-11-2023** | **Parashikimi** nga 07-11-2023, ora 12:00 deri më 08-11-2023, ora 23:59. |
|---|---|

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 07 – 08.***

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
| | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
| | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
| | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
| | Rrëshqitje toke |